



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.581/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi anëtar dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Florentina Gjergjaj nga Gjakova, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar verifikimin e rezultateve të votave të nxjerra gjatë numërimit dhe rinumërimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet i bazuar apeli me numër Anr.581/2021 i datës 04.03.2021, i parashtruar nga Florentina Gjergjaj nga Gjakova, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar verifikimin e rezultateve të nxjerra gjatë numërimit dhe rinumërimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëron fletëvotimet me kusht në të gjitha Komunitetet e Kosovës dhe të gjitha fletëvotimet nga diaspora, vetëm sa i përket kandidateve nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të bashkëngjiten në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

Me datë 04.03.2021, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Florentina Gjergjaj ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.581/2021, me të cilën pretendon se në rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ, duke u mbështetur në FRK-të, kandidatja Florentina Gjergjaj ka 3855 vota, ndërsa kandidatja Meliza Haradinaj- Stublla ka 3715 vota .

Si dëshmi për pretendimet e saj ka bashkëngjitur në apel rezultatet e QNR-së të datës 26.02.2021.

Duke u mbështetur në bazën e të dhënave në QNR pas rinumërimit të 494 kutive të votimit të datës 27.02.2021, figurojnë këto rezultate: Ramush Haradinaj 38878 vota, Daut Haradinaj 12712 vota, Besnik Tahiri 7308 vota, Bekë Berisha 7100 vota, Time Kadrija 6264 vota, Pal Lekaj 6149 vota, Shemsedin Dreshaj 6100 vota, Lahi Brahimaj 5940 vota, Albena Reshitaj 5600 vota, Arbër Tolaj 5495 vota, Anton Shala 5303 vota, Skumbin Demaliaj 5237 vota, Gazmend Sylaj 5146 vota, Hajdar Sutaj 5092 vota, Rasim Selmanaj 4894 vota, Haxhi Shala 4787 vota, Ramë Likaj 4597 vota, Albana Bytyqi 4230 vota, Florentina Gjergjaj 4005 vota, Meliza Haradinaj- Stublla 3953 vota. Më tutje thekson se pas numërimit të votave me kusht në tabelën e rezultateve në qendër të numërimit të datës 01.03.2021 kandidatja Meliza Haradinaj -Stublla barazohet me kandidaten Florentina Gjergjaj me nga 4091 vota për secilën. Ankuesja pretendon po ashtu se në tabelën e rezultateve të datës 02.03.2021 të orës 24:00 pas numërimit përafërsisht 50% të votave me postë të gjithë kandidatët ruajnë renditjen e njëjtë, ndërsa kandidatja Meliza Haradinaj -Stublla, e kalon kandidaten Florentina Gjergjaj me diferencë votash 51 vota, ndërsa në tabelën e rezultateve të 03.03.2021 të Qendrës së Numërimit të votave të orës 24:00 të gjithë kandidatët e lartcekur ruajnë pozicionimin e njëjtë në renditje përpos Meliza Haradinaj- Stublla e cila kalon kandidaten Albana Bytyqi dhe Florentina Gjergjaj, këto rezultate shpallen si rezultate përfundimtare nga KQZ në mbledhjen e datës 04.03.2021.

Si dëshmi për pretendimet e saj ka bashkangjitur rezultatet online të numërimit të KQZ-së të datës 01.03.2021, të datës 02.03.2021 ora 24:00 dhe të datës 03.03.2021 ora 24:00.

Më tutje ka shtuar se të gjitha këto fakte vërtetojnë dyshimet se kandidates Meliza Haradinaj -Stublla, në mënyrë artificiale iu është rritur numri i votave nga personat që kanë futur të dhënat në sistem apo nga personat kompetent të cilët kanë bërë numërimin dhe rinumërimin e votave, si dhe numërimin e votave me kusht dhe atyre me postë, pasi që është e pabesueshme si fakti se vetëm njëri nga kandidatët në listën e AAK-së të ndryshoj pozicion të vazhdueshëm gjatë numërimit duke pasur parasysh se AAK në votat me kusht dhe votat me postë përafërsisht ka fituar 3000 vota në total, ndërsa të njëjtës i shtohen 709 vota nga këto vota të numëruara që i bijnë afërsisht 1/3 e votave me kusht dhe afërsisht sa 1/4 e votave të fituara në rezultatet preliminare të datës 26.02.2021 ora 14:00. Andaj duke u bazuar në këto fakte ankuesja kërkon nga PZAP që të aprovohet apeli, e të urdhëroj QNR-në që të bëjë auditimin dhe verifikimin e rezultateve të nxjerra gjatë numërimit dhe rinumërimit, dhe të urdhërohej QNR-në që të bëjë rinumërimin e të gjitha votave për kandidatet Florentina Gjergjaj 64, Albana Bytyqi 57 dhe Meliza Haradinaj Stublla 12.

Në përgjigje në apel të datës 05.03.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se të gjitha pretendimet e ankueses iu ka referuar rezultateve përmes kanaleve jo zyrtare dhe thirret në rezultatet e pakompletuara, duke u thirrur se ka shtim të votave të një kandidat tjetër, rezultate të cilat i ka marr të pakompletuara dhe të cilat kanë qenë në proces të vazhdueshëm të procesimit të rezultateve. Gjatë procesimit të rezultateve të vendvotimeve të rinumëruara, votave me kusht dhe votave me poste ndryshohet vazhdimisht gjendja e votave

të kandidatëve varësisht rezultateve që gjenden në FRK, të cilat janë te publikuara në uebfaqen e KQZ-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Florentina Gjergjaj, kandidate për deputete nga radhët e subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.581/2021, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet nga diaspora, vetëm sa i përket subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dhe kandidatëve për deputet të këtij subjekti politik.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.581/2021, provave të bashkangjitura në apel, përgjigjes në apel nga ana e KQZ-së, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Florentina Gjergjaj, kandidate për deputete nga radhët e subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është i bazuar.

Paneli për Ankesa dhe Parashtresa vlerëson se pretendimet e kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës Florentina Gjergjaj, janë të bazuara. Në rastin konkret nga provat që janë bashkangjitur në ankesë siç janë rezultatet online të numërimit të KQZ-së, të datës 01.03.2021, të datës 02.03.2021 ora 24:00 dhe të datës 03.03.2021 ora 24:00, dhe nga rrjedhja e ndryshimit të rezultateve për kandidatet në fjalë për datat e lartcekura të paraqitura online, krijohen paqartësi se si kandidatja Meliza Haradinaj – Stublla kalon me vota kundër kandidaten nga i njëjti subjekt politik Albana Bytyqi dhe Florentina Gjergjaj. Një ndryshim i tillë i rezultateve të pretenduara, krijon mos besueshmëri, në transparencën dhe kredibilitetin e numërimit të votave nga ana e komisionerve, andaj paneli vendosi që ti dërgoj në rinumërim fletëvotimet për kandidatët nga radhët e subjektit politik AAK-së.

Gjithashtu Paneli, me marrjen e informatës, për ekzistimin e një video – audio, ashtu siç është njoftuar edhe opiniononi i gjerë, përmes rrjeteve të informimit se ka pasur parregullsi në rastin e numërimit dhe bartjes së rezultateve në raport me subjektin ankues dhe subjektin tjetër që pretendohet si përfitues nga ana e ankuses, e që vinë nga i njëjti subjekt politik. Video - audio e publikuar në mjetet e informimit, konsiderohet se është provë që forcon bindjen e paneli të vendos për dërgimin në rinumërim të votave me kusht dhe ato nga diaspora, në raport me kandidatët e AAK-së, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit, në mënyrë që të qartësohen të gjitha dyshimet e supozuara në apel.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se

lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si nën pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve me kusht në të gjitha Komunat e Kosovës dhe të gjitha fletëvotimet nga diaspora nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 581/2021 më datën 08.03.2021.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

